



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER

PLANI VJETOR  
PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024

## PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT

---

Plani vjetor i gjimnazit “Perikli Ikonomi” Fier për vitin shkollor 2023-2024 hartohet mbështetur në:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, nenet 51, 52 dhe 53;
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 15, datë 24.7.2023 “Për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar”;
- Planin afatmesëm të shkollës 2022-2026.

Hartimi i këtij plani ka filluar me analizën e detajuar që drejtorja e shkollës u ka bërë rezultateve të arritura në përfundim të vitit shkollor në qershor 2023, të rezultateve të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore të këtij viti dhe përpunimit të të dhënave për plotësimin e Kartës së Performancës së shkollës për vitin 2022-2023.

Në përcaktimin e objektivave të vitit shkollor është mbajtur parasysh edhe plani për zbatimin e projektit “Qëndro” në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë italiane dhe UNICEF Shqipëri, pjesë e të cilit është edhe gjimnazi “Perikli Ikonomi”.

Në përfundim të vitit shkollor 2022-2023, nga drejtorja e shkollës u hartua edhe raporti vjetor, prej të cilit dalin edhe treguesit analitikë të paraqitur, si edhe konkluzionet mbi gjendjen e shkollës dhe realizimin e planit të atij viti.

Në fund të muajit gusht u ngrit edhe grupi i punës për formatimin e planit për vitin e ri shkollor 2023-2024, i kryesuar nga drejtorja e shkollës. Ky grup përbëhet nga:

1. Natasha Mino, drejtore
2. Tahir Latifi, nëndrejtor
3. Aurela Lala, mësuese
4. Anila Ikonomi, mësuese
5. Suela Hatija, prind
6. Kejsa Naçi, nxënëse

Në javën e parë të shtatorit plani i hartuar iu paraqit bordit të shkollës.

Plani vjetor i shkollës i paraqitet sipas grafikut Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier dhe zbatohet prej datës 11.9.2023.

## ANALIZA E GJENDJES

---

### 1. Ndjekja e IA-së (përqindja e braktisjes së shkollës, përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore).

Nga numri i nxënësve të regjistruar në shtator-tetor 2022 (468 nxënës), deri në fund të vitit shkollor ishin larguar gjithsej 37 nxënës ose përafërsisht 8% e kontingjentit. Një vit më parë ky tregues ishte 12% e kontingjentit të shtatorit 2022. Pra, vihet re progresi i përcaktuar edhe në planin vjetor të vitit 2022-2023, duke iu larguar nivelit më të ulët në disa vite që ishte në fund të vitit shkollor 2021-2022 dhe që rrezikoi edhe realizimin e planit afatmesëm 2018-2022 në vitin e fundit të tij, ku synimi ishte rritja sasiore e shkollës. Janë analizuar disa tregues dhe është arritur në përfundimet e mëposhtme.

Gjatë vitit 2022-2023 u larguan jashtë vendit apo shkolla në qytete apo zona të tjera 17 nxënës. Ndërsa 10 të tjerë ose rreth 2% e kontingjentit janë transferuar në shkolla brenda qytetit të Fierit, kryesisht në ato private. Në total 20 nxënës, 4% e kontingjentit të shtatorit 2022, janë largime nga shkolla për arsye që mund të shmangen pjesërisht me ndërhyrjen e shkollës.

Në analizën e treguesve disa tregues llogariten negativisht për shkollën tonë.

Është fakt se jo të gjithë të larguarit jashtë vendit kanë tërhequr dokument shpërnguljeje nga shkolla, megjithëse pre një pjesë janë marrë deklarata prej të afërmeve për largimin e tyre jashtë shtetit. Numri i nxënësve të përjashtuar për arsye mungesash është 3 ose 0,6% e kontingjentit, ndërsa 7 nxënës të tjerë (1,5%) janë larguar pa dhënë ndonjë arsye, jozyrtarisht vlerësojmë se edhe ky grup janë të larguar jashtë vendit.

Për nxënësit e larguar në shkolla të tjera brenda qytetit vlerësojmë se lehtësitë që u ofrohen nga IA private për rezultate të larta janë arsye kryesore e këtyre transferimeve.

Gjatë vitit shkollor 2022-2023 nxënësit kanë munguar mesatarisht në 1,58% të orëve mësimore, duke mos arritur njërin nga objektivat e përcaktuar për këtë vit në planin vjetor.

*Anë e fortë:*

*Zbatimi i masave disiplinore për nxënësit që mungojnë pa arsye, ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë për evidentimin e mungesave dhe informimi i shpejtë i prindërve për mungesat e nxënësve kanë efekt në ndërgjegjësimin e nxënësve në frekuentimin e rregullt të shkollës.*

*Anë të dobëta:*

*Tendencë largimi i nxënësve për arsye të tjera që nuk lidhen me shkollën. Kontaktimi i prindërve për mungesat e nxënësve nuk është i menjëhershëm, pjesërisht sepse kanë qenë të padisponueshëm, informimi i mësuesve kujdestarë ka qenë i ngadaltë.*

## 2. Aspekti social

Në aspektin social edhe gjatë vitit shkollor 2022-2023, në vijim të punës dhe përvojës së viteve të fundit, gjimnazi ynë ia ka dalë të jetë gjithëpërfshirës, i hapur për shtresat e marginalizuara, në kushte të pafavorshme sociale dhe për nxënësit nga kultura të ndryshme. Prej hartës sociale të shkollës për vitin 2022-2023, hartuar nga punonjësja e shërbimit psikosocial, rezulton se rreth 4% e nxënësve (20 nxënës) vijnë nga familje me nivel shumë të ulët ekonomik. 11 nxënës ishin jetimë me një prind. 15 nxënës ose 3% e nxënësve të të gjithë shkollës vinin nga familje me prindër të divorcuar. Të gjithë kata tregues kanë shënuar përbindje më të larta se një vit më parë, çka shtoi nivelin e vështirësisë me të cilën u përball shkolla. Megjithatë nuk u evidentuan probleme me këtë kontingjent.

Rreth 50% e prindërve të nxënëve ishin me nivel të ulët arsimor (arsim bazë), më pak se 40% e tyre ishin me arsim të mesëm. Ky tregues është i lidhur drejtpërdrejt me një shkallë të lartë mosangazhimi prej këtyre prindërve në përpjekjet e shkollës për të përmirësuar në veçanti frekuentimin e rregullt të fëmijëve të tyre.

Një pjesë e konsiderueshme (mbi 30%) e nxënësve jetonin në periferi të qytetit ose në zona rurale rreth tij dhe përdornin mjetet e transportit publik për të ardhur në shkollë. Megjithatë këta nxënës nuk shfaqën probleme me zbatimin e orarit.

Në fillim të vitit të kaluar shkollor, në hartën sociale të shkollës u evidentuan 26 nxënës (6% e kontingjentit) si nxënës që shfaqnin talent në fusha të caktuara, ndërsa nxënës me vështirësi në të nxënë nuk janë evidentuar nga shërbimi psikosocial.

Në gjimnazin tonë ka frekuentuar vetëm një nxënëse nga komuniteti rom, e cila përfundoi me sukses klasën XI. Në mënyrë të vazhdueshme janë bërë përpjekje për të afruar edhe nxënës të tjerë nga ky komunitet, prej shkollave 9-vjeçare të afërta, por nuk ka pasur rezultat domethënës.

Gjatë vitit shkollor 2022-2023 ka frekuentuar gjimnazin tonë edhe një nxënëse me shtetësi të huaj (italiane), e cila u largua pa përfunduar vitin. Kjo nxënëse, si edhe të tjerë një vit më parë, kanë gjetur një klimë shumë pozitive të ndihmës dhe mirëkuptimit nga bashkëmoshatarët dhe personeli mësimor në shkollën tonë.

*Anë e fortë:*

*Nuk ka numër të lartë të kategorive problematike të nxënësve.*

*Anë e dobët:*

*Konstatohet indiferencë nga prindërit e nxënësve që mungojnë në shkollë dhe mungesë bashkëpunimi nga komuniteti për mbështetjen e tyre.*

### 3. Rezultatet e nxënësve

Në statistikën e përfundimit të vitit shkollor 2022-2023, treguesit e qershorit 2023, u prezantuan treguesit e mëposhtëm mbi rezultatet e nxënësve në mësim gjatë këtij viti:

Nota mesatare e nxënësve të të gjithë shkollës për vitin shkollor është 7,65, ndërsa një vit më parë, në qershor 2022, ishte llogaritur në 7,5, ndërsa në qershor 2021 u raportua 7,42. Kalueshmëria e nxënësve të shkollës për këtë vit shkollor (statistikën e qershorit 2023) ishte 94,4%, ndërsa në qershor 2020 ishte 93,8%. Niveli i synuar në planin vjetor të vitit shkollor ishte paksa më i lartë, 95%, që nuk u arrit të realizohej për 0,6% nga diferenca prej 1,2%.

Pas provimeve të klasës në sesionin e dytë kaluan në klasën pasardhëse edhe 21 nxënës të klasave X dhe XI, duke rritur kalueshmërinë në nivelin 99,3% nga 98,5% një vit më parë. Diferenca mes notave vjetore dhe atyre të provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2023 llogaritet në shifrën 0,53, ndërsa një vit më parë ishte 0,33. Por, në këto tri provime përqindja e nxënësve që rezultuan me diferencën (në vlerë absolute) më të madhe se 1 notë ishte 47,9% nga 21,2% një vit më parë.

*Anë e fortë:*

*Kalueshmëria dhe nota mesatare e nxënësve është më të lartë se një vit më parë.*

*Anë e dobët:*

*Ka rritje të diferencës midis vlerësimit të brendshëm me notë (nota vjetore) dhe atij të jashtëm (nota e provimeve), krahasuar me një vit më parë.*

### 4. Treguesit për të cilët shkolla ka arritjen më të mirë dhe më të ulët në renditje për institucionet arsimore të suksesshme në nivel ZVA-je.

Ende nuk është publikuar renditja e institucioneve arsimore në shkallë ZVA-je, në bazë të treguesve të kartës së performancës.

Megjithatë kemi llogaritur që gjimnazi ynë është e vetmja shkollë publike konkurrente e institucioneve arsimore private në fazën e dytë të olimpiadave, duke dalë me fitues të vendeve të para dhe të dyta në kimi, biologji, informatikë, letërsi dhe histori, përkundrejt gjimnazeve të tjera publike që janë fitues vetëm në olimpiadën e letërsisë.

## 5. Etika dhe sjellja

Gjatë vitit shkollor 2022-2023 ka pasur ankesa për të cilat është mbledhur komisioni i etikës dhe sjelljes në shkollë. Nuk ka qenë e nevojshme marrja e masave disiplinore.

*Anë e fortë:*

*Shkolla ka një oficerë sigurie aktive gjatë kohës së funksionimit të shkollës, e cila ka bashkëpunim të plotë me mësuesit dhe strukturat e policisë.*

*Anë e dobët:*

*Ende ndihen pasojat nga periudha e pandemisë në disiplinimin e nxënësve në marrëdhënie me njëri-tjetrin.*

## 6. Arritjet në provimet kombëtare dhe në testimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në sesionin e parë në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore 2023 u arrit një nivel kalueshmërie 99,3% sipas mënyrës së përlllogaritjes së kartës së performancës; ky tregues është më i lartë se ai i një viti më parë (96,9%). Në përfundim të sesionit të parë të MSH kalueshmëria ishte 95%, ndërsa në përfundim të sesionit të dytë në total arriti në 98,5%.

Në sesionin e parë në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë kaluan 98,5% e nxënësve (përafërsisht sa vjet), me notë mesatare 7,6 (vjet ishte 7,3). Në provimin e matematikës kalueshmëria në qershor ishte mbi 99,3 nga 94% një vit më parë, me notë mesatare 6,4 (sa një vit më parë). Ndërsa në provimin e gjuhës angleze në qershor kaluan mbi 100% e maturanëve (nga 98% një vit më parë) dhe nota mesatare ishte 7,6 nga 7,5 para një viti. Nota mesatare e tri provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2023 ishte 7,11, me një rritje të lehtë krahasuar me qershorin 2022 (7,08) ose ndjeshëm më e lartë se në qershor 2021 (6,8). Në provimin me zgjedhje rezultatet janë më të ulëta: kalueshmëria është në nivelin 96,2% dhe nota mesatare 6,8.

Gjatë vitit shkollor nuk kanë qenë zhvilluar testime të tjera kombëtare ose ndërkombëtare me nxënësit e shkollës sonë.

*Anë e fortë:*

*Ka përmirësim të cilësisë së shkollës në treguesin e kalueshmërisë dhe të notës mesatare vjetore.*

*Anë e dobët:*

*Rezultati e maturanëve në provimin me zgjedhje është më i ulët se në provimet e detyruara.*

**7. Mësuesit: përqindja e orëve mësimore të munguara nga mësuesit kundrejt të gjitha orëve mësimore, numri i krediteve të punonjësve arsimorë.**

Ky tregues nuk përfshihet më në treguesit e performancës së shkollës për vitin 2022-2023. Nuk ka pasur mungesa të pajustificuara nga ana e mësuesve. Një mësuese, për arsye shëndetësore, ka munguar për periudha të gjata, por nuk është zëvendësuar nga ZVA.

Në vitin shkollor nuk ka pasur mësues në kualifikimin profesional.

Gjatë vitit 2022-2023 drejtuesja e shkollës ka përfunduar me sukses trajnimin e detyruar në Shkollën e Drejtorëve, duke u certifikuar me 27 kredite.

*Anë e fortë:*

*Nivel i lartë i disiplinës në punë dhe angazhimit të personelit.*

*Anë e dobët:*

*Mësuesit që mungojnë për periudha të gjata nuk zëvendësohen..*

**8. Pjesëmarrja në projekte me OJF, në olimpiada, konkurse, gara.**

Duke përmbushur me sukses njërin prej objektivave të planit vjetor 2022-2023, nxënësit e shkollës sonë morën pjesë denjësisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Qendra e Kulturës e Bashkisë Fier, me miratimin e ZVA Fier, dhe në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare në lëndët e biologjisë, kimisë, informatikës, letërsisë dhe historisë. Në fazën e dytë të olimpiadave nxënësit tanë fituan një vend të parë dhe dy vende të dyta në biologji, një vend të dytë në kimi, vendin e dytë në informatikë, nga një vend të dytë në letërsi dhe në histori.

Në kampionatin e pingpongut mes shkollave, organizuar nga Qendra Kulturore e Bashkisë Fier në bashkëpunim me ZVAP Fier, nxënësit tanë fituan në krosin e vjeshtës vendin e parë për vajza, dy vende të dyta për djem dhe për vajza, në kampionatin e shahut fituan një çmim të dytë dhe një çmim të katërt, në kampionatin e futbollit zunë vendin e katërt, në kampionatin e basketbollit për vajza vendin e katërt, vendin e dytë në kampionatin e volejbollit për djem, vendin e parë për djem dhe vendin e tretë për vajza në kampionatin e pingpongut.

Në konkursin kombëtar “Mendimi im, forca ime” nxënësja e shkollës sonë zuri vendin e tretë.

Gjatë vitit shkollor 2022-2023 është bashkëpunuar me KOKSH-in për projektin “Ekipet sportive 2022” me krijimin dhe aktivizimin e dy ekipeve të basketbollit, me qendrën

“Epoka e Re” në kuadër të programit për të rinjtë - YOUth Think Green TEYC dhe programit për edukimin e karrierës.

Në projektin e përbashkët “Ndihma e parë e avancuar” të Kryqit të Kuq Shqiptar me Kryqin e Kuq Austriak u realizua trajnimi i tre mësuesve dhe një nxënësi, si edhe trajnimi i një grupi nxënësish për ndihmën e parë.

Nxënësit e shkollës sonë morën pjesë në projektin “Universi jemi ne”, në maj 2023 të organizuar nga ZVA dhe Prefekti i Qarkut Fier, me një pjesë teatrore me temën e barazisë gjinore duke fituar vendin e parë për tematikën e zgjedhur dhe për interpretimin.

*Anë e fortë:*

*Nxënësit e shkollës sonë po prezantojnë talentin e tyre në disa fusha, në shkencat e natyrës, shkencat humane, në sport dhe aftësi për jetën.*

*Anë e dobët:*

*Ende nuk është konsoliduar puna e diferencuar me talentet nëpërmjet klubeve shkencore.*

## **9. Qëndrimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja.**

Për vlerësimin e shkollave, ZVA Fier ka zhvilluar në muajin maj pyetësorët e kartës së performancës me nxënësit, prindër dhe mësues të shkollës.

Përceptimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të gjimnazit tonë shprehet si më poshtë:

87,4% e nxënësve shprehen se “janë plotësisht dakord” ose “dakord” mbi cilësinë e shkollës (përdorimin e TIK dhe nevojës për të plotësuar njohuritë në kurse private).

100% e nxënësve janë shprehur “plotësisht dakord” ose “dakord” kur pyeten mbi përkrahjen dhe trajtimin e drejtë e të barabartë të mësuesve dhe personelit ndaj tyre.

100% janë shprehur pozitivisht (“plotësisht dakord” ose “dakord”) se ndihen të sigurt në mjediset e shkollës dhe se vijnë me dëshirë në shkollë.

*Anë e fortë:*

*Shumica e nxënësve mendojnë pozitivisht për personelin mësimor, cilësinë dhe sigurinë në shkollë (83%).*

*Anë e dobët:*

*Ka një numër nxënësish që shprehen negativisht mbi qëndrimin e papërshtatshëm të mësuesve në rastet e sjelljes së gabuar të nxënësve (17%).*



## SYNIMI

Synimi ynë lidhet me dy prioritetet e përcaktuara në planin afatmesëm të shkollës: “Rritja e interesit të nxënësve për shkollën, dëshmuar me nivel më të lartë të frekuentimit të orëve mësimore dhe klubeve shkollore, si edhe uljes së numrit të nxënësve që largohen drejt shkollave të tjera” dhe “Përforcimi i imazhit të shkollës si institucion arsimor cilësor nëpërmjet arritjeve më të larta në aktivitetet konkurruese krahasuar me gjimnazet publike të ZVAP Fier dhe në rezultate më pozitive në provimet e maturës”.

Për vitin shkollor 2023-2024 synimi ynë do të vazhdojë të jetë:

**Konsolidimi i imazhit pozitiv për shkollën tonë nëpërmjet rritjes cilësore në shumë drejtime, për t’u kthyer në shkollën ku nxënësit realizojnë ëndrrat dhe dëshirat.**

## OBJEKTIVAT

1. Deri në fund të vitit 2023-2024 të minimizohet në nivelin 3,4% numri i nxënësve të përjashtuar, të larguar në shkolla brenda qytetit ose pa arsye, nga niveli prej 4,3% për vitin 2022-2023.

*Nuk llogariten transferimet e nxënësve në shkolla jashtë qytetit apo largimet e dokumentuara jashtë vendit. Llogaritet numri i nxënësve të larguar si më sipër, krahasuar me numrin e nxënësve të shkollës të raportuar me statistikat e fillimit të vitit shkollor.*

2. Në përfundimet e qershorit 2024 niveli i kalueshmërisë së shkollës të rezultojë 95% nga niveli prej 94,4% për vitin 2022-2023.

*Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.*

3. Në vitin shkollor 2023-2024 nxënësit tanë të fitojnë 20 vende/çmime të vlerësuara në aktivitetet konkurruese të organizuara nga ose në bashkëpunim me ZVA Fier, nga 18 vende të fituara në vitin 2022-2023.

*Në këtë tregues përfshihen edhe vendet fituese të shpallura nga ZVAP Fier në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare.*

## VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për vëzhgimin e zbatimit të planit gjatë gjithë vitit shkollor 2023-2024 ngarkohet një grup pune i përbërë nga:

1. Natasha Mino, drejtore
2. Arnisa Shehu, përfaqësuese e komunitetit
3. Ilirjan Lugaj, mësues
4. Rudina Rista, prind
5. Suela Hatija, prind

Objektivi	Nr.	Veprimtari vëzhguese	Afati
Deri në fund të vitit 2022-2023 të minimizohet në nivelin 3,4% numri i nxënësve që përjashtohen apo largohen nga shkolla pa arsye, nga niveli prej 4,3% për vitin 2021-2022.	1	Evidentimi i hershëm i nxënësve problematikë në ndjekjen e shkollës	Tetor 2023
	2	Analizë për çështjet e informimit të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve të rrezikuar dhe raportimit të problematikave të reja në drejtori	Nëntor 2023, janar 2024, mars 2024
	3	Krijimi i bazës së të dhënave për ndjekjen e mësimit nga nxënësit	Nëntor 2023
	4	Mbledhje e posaçme e grupit të punës dhe këshillit të mësuesve	Tetor 2023, mars 2024
Në përfundimet e qershorit 2024 niveli i kalueshmërisë së shkollës të rezultojë 95% nga niveli prej 94,4% për vitin 2022-2023.	1	Analizë për të përcaktuar lëndët ku ka pasur dobësi dhe mësuesit	Dhjetor 2023
	2	Hartimi i planit të posaçëm me mësuesit e lëndëve dhe kujdestarë për ndryshimin e gjendjes në pikat e dobëta të konstatuara	Janar 2024
	3	Raportim për nivelin e arritjeve të nxënësve të rrezikuar për të mbetur në klasë	Mars 2024

<b>Objektivi</b>	<b>Nr.</b>	<b>Veprimtari vëzhguese</b>	<b>Afati</b>
	4	Analizë pune e arritjeve në përmbushjen e objektivit	Prill 2024
	5	Mbledhje e posaçme e këshillimit të mësuesve për kalueshmërinë	Prill 2024
Në vitin shkollor 2023-2024 nxënësit tanë të fitojnë 20 vende/çmime të vlerësuara në aktivitetet konkurruese të organizuara nga ose në bashkëpunimim me ZVA Fier, nga 18 vende të fituara në vitin 2022-2023.	1	Evidentimi i nxënësve që kanë prirje në lëndë të caktuara të olimpiadave	Shtator-tetor 2023
	2	Hartimi dhe përshtatja e planeve të klubeve shkollore dhe orientimi drejt përgatitjes për aktivitetet konkurruese	Shtator-tetor 2023
	3	Analizë e çdo olimpiade dhe aktiviteti kulturor e sportiv konkurrues	Dhjetor 2023, janar-prill 2024

### **BUXHETI**

Për realizimin e objektivave të planit nuk parashikohet buxhet i veçantë. Për këtë vit shkollor shkolla synon që të tërheqë donatorë për realizimin e projekteve cilësore.